



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË
KRYETARI

Nr. 663 prot.

Korçë më, 25/01 / 2019

URDHËR

Nr. 40, datë 25/01 / 2019

Për një ndryshim në urdhërin nr. 138, datë 21.03.2017, "Për miratimin e orareve dhe stacioneve të qëndrimit të linjave të rregullta rrethqytetëse të transportit rrugor të udhëtarëve brenda vendit", të ndryshuar

Pasi shqyrtova relacionin e datës 22.01.2019, paraqitur nga Drejtoria e Kontrollit të Territorit, lidhur me oraret e funksionimit të linjës së rregullt rrethqytetëse të transportit rrugor të udhëtarëve Voskop–Korçë–Voskop, mbështetur në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998, "Për transportet rrugore", i ndryshuar, neni 15, neni 19; ligjin nr. 139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, neni 64, pika b; udhëzimin nr. 5627, datë 18.11.2016, e Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, "Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e liçencave dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit", i ndryshuar, neni 8; vendimi i Këshillit të Bashkisë Korçë nr. 17, datë 03.03.2017, pika 2, "Për miratimin e linjave të rregullta rrethqytetëse të transportit rrugor të udhëtarëve brenda vendit", i ndryshuar;

URDHËROJ:

1.Në urdhërin e Kryetarit të Bashkisë Korçë nr. 138, datë 21.03.2017, "Për miratimin e orareve dhe stacioneve të qëndrimit të linjave të rregullta rrethqytetëse të transportit rrugor të udhëtarëve brenda vendit", të ndryshuar, oraret e nisjes dhe kthimit të linjës së rregullt rrethqytetëse të transportit të udhëtarëve Voskop–Korçë–Voskop, ndryshohen si më poshtë.

1.	LINJA NR. 6/1	Voskop – Korçë –Voskop
2.	Oraret e nisjes	07 ¹⁵ , 08 ⁰⁰ , 08 ³⁰ , 09 ⁰⁰ , 10 ⁰⁰ , 13 ¹⁵ , 16 ³⁰ .
3.	Oraret e kthimit	07 ³⁰ , 08 ³⁰ , 09 ⁰⁰ , 12 ³⁰ , 14 ⁰⁰ , 15 ⁰⁰ , 17 ⁰⁰ .

2.Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet Drejtoria e Kontrollit të Territorit dhe Policia Bashkiake Korçë .

3.Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Konceptoi
N. Lika

Drejtoria e Përgjithshme Juridike
A. Dishnica

KRYETARI
Sotiraq Filo

